

470-05/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, me gjyqtarin *Nazim Vllaçon* e me procesmbajtësen *Shqipe Simitçiun*, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Nue Oroshi, nga fshati Caparc KK Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, 6 parag. 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, e në bazë të neni 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën 17.10.2013

AKTVENDIM

I pandehuri Nue Oroshi nga i ati Mark, i lindur më 1970 në fshatin Caparc ku edhe jeton, me kombësi shqiptar, magjistër i Historisë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar për kundërvajtje.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S


Sepse si Zyrtarë i Lartë Publikë –Këshilltar i Kuvendit Komunal në Prizren, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012 deri më datën 31.03.2012 sipas kërkesës së Agjencisë kundër Korrupsionit.

-me të cilën veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050 të ndëshkuar sipas neni 17 paragrafi.3 të këtij Ligji prandaj edhe

D Ë N O H E T

Me gjobë në lartësi prej 350.00 EURO (treqindepesëdhjetë) euro.

I pandehuri është i obliguar që gjobën e shqiptuar të paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktvendimit, e në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me denim burgimi në atë mënyrë që për çdo 20 Euro të gjobës do të caktohet nje dite burg. Obligohet se në afatin e njëjtë të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë paushale prej 5 EURO me kërcënim të përmbarimit me detyrim. Obligohet e pandehura që pas kryerjes së gjobës dhe të shpenzimeve të lajmërojë Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Prizren.



Arsyetim

Me kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit të Republikës së Kosovës me nr.01-1885/12 të datës 24.05.2012 u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Nue Oroshi nga fshati Caparc KK Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 11.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

Gjendja faktike e përshkruar më përsëafërmi si në dispozitiv të këtij aktvendimi është vërtetuar në bazë të deklaratës së të pandehurit, deklaratës së zyrtarit kontaktues me Agjencionin kundër Korrupsionit Samir Hoxha, si dhe me administrimin e provave tjera në shkresat e lëndës.

I pandehuri në deklaratën e tij ka mohuar kundërvajtjen që i vihet në barrë duke theksuar se me kohë ka deklaruar pasurinë Agjencionit kundër Korrupsionit dhe ka deklaruar që gjykatës si dëshmi do ta prezentojë vërtetimin mbi deklarin e pasurisë dhe ate deri më datën 10.12.2012.

I pandehuri deri para marrjes së aktvendimit nuk ka prezentuar asnjë prove lidhur me deklarin e pasurisë Agjencionit kundër Korrupsionit.

Zyrtari kontaktues me Agjencionin kundër Korrupsionit Samir Hoxha se deklaruar se me afat kohore kishte njoftuar Zyren Ligjore të KK Prizren lidhur me njoftimin e këshilltarëve për deklarin e pasurisë dhe ate më datën 15.02.2012 dhe më datën 02.03.2012 në mënyrë elektronike të cilat prova i njëjti ka prezentuar gjykatës si dëshmi, ndërkaq në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të gjithë Këshilltarëve ua kishte shpërndarë kopjet e formularëve për deklarin të pasurisë. nuk ka pranuar asnjë lloj të formularit për deklarin vjetor të pasurisë.

Gjyqtari ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit por të njëjtën e ka vlerësuar si shmangie nga përgjegjësia kundërvajtëse ngase me provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës pamëdyshje është konstatuar se i njëjti e ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë andaj është shpallur përgjegjës dhe dënuar sipas ligjit.

Gjatë caktimit të dënimit janë vlerësuar rrethanat nga neni 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pesha e kundërvajtjes së kryer dhe pasojat e saja, shkalla e përgjegjësisë si dhe rrethanat materiale të pandehurit.

Gjyqtari aplikoi nenin 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet duke ia shqiptuar dënimin nën masën minimale të dënimit për këtë kundërvajtje pasi që i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar për kundërvajtje, qëndrimi i tij korrekt para gjykatës fakte këto të cilat nuk e përjashtojnë nga përgjegjësia kundërvajtëse por që në masë të konsiderueshme e zvogëlojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzimet e procedurës janë të caktuara në bazë të nenit 109 al.2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE

Dt.17.10.2013

Procesmbajtësja
Shqipe Simitçiu



Nr.470/05-2012

Gjyqtari
Nazim Vllaço

03-3584/13/03
sluzj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi e në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj gjykate pa taksa.